



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Date 12.12.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për rrugë- 45233120-6 - Punime ndërtimi për rrugë dytësore -45233123-7

VLERA E FONDIT LIMIT: : **32548556** (tridhjetë e dy milion e pesëqind e dyzete e tete mije e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH .

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,si dhe ne aktin normativ nr.10 date 18.05.2022” Per kompesimin financiar te cmimit per disa materiale ndertimi sipas percaktimit te kontrates per pune publike si pasoje e situates se vecante te krijuar ne treg gjate vitit 2022” me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Cërrik**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e ofertes, sipas shtojces 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas shtojces 8 te DST.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël 40% se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet. Konkretiaht 32548556(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese OE arrin vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia

Cerrik dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020,2021) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

*Shënim:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin **2021 dhe kestet e matura për vitin 2022** duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin leshuar nga Autoriteti perkates ne te cilen eshte regjistruar sipas QKB) .

***Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.*

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës **që prokurohet leke pa tvsh.**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

***Pika 2.3.1 germa a)** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Kurse pika 2.3.1 germa /b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Ne rastin kur operatorët ekonomikë anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore,
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore,

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të Operatoreve ekonomike si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Per kontratat e realizuara si nenkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- N.P- 1 A Punime germimi ne toke
- NP- 4 B Rruge, Autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvai, metro, pista aeroportuale

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrjnë Veprimtari Ndertimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N-P -1 A	<i>Punime germimi ne toke</i>	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , në kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet,	A	0-20 milion
N-P- 4B	<i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro,</i>	Rikonstruksioni i rruges Dasar, Nja Mollas	B	21-50 milion

	<i>pista aeroportuale.</i>			
NS-18-A	<i>Punime topogjeodezike</i>	Nenshtrese zhavor	A	0-20 milion

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të këtij objekti, si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- *N.P-1A Punime germimi ne toke*

Referuar Preventivit janë parashikuar kryerja e punimeve të gërmimit, si pjesë seksioni e veçantë. Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se “N.P. I Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore”.

- *NP- 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.*

Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

PËR PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

Referuar Lidhjes 4 të VKM 42/2008 parashikohet se Klasa A për punime me vlerë 0- 20 milion lekë- në proporcion me fondin limit.

- *NS 18 B Punime topogjeodezike*

Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se: NS 18 B Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt, i cili duhet te jete i perfshire ne licensen e shoqerise dhe te deklaroje se nuk eshte i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtme.

- libreze pune
- Kontrate pune e vlefshme
- Diplome

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator duhet të percaktoje me ane të një deklaratë Drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.4 - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **50 punonjës**. Te cilët duhet të figurojnë në listepagesa e shoqërisë minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vertetuar me:

- Vërtetim të lëshuar Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.

Argumentim: *Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje , tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të

punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5-Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të kete te punesuar staf inxhinier per kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt. Te perfshire ne licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale , te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, libreze pune, diplome perkatese si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise minimum per periudhen 3 (tre muajve) nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi profili transport
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierëve:

1 (nje) inxhinier ndërtimi- Kerkohet Inxhinieri pasi kemi te bejme me rikonstruksione te rrugeve. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndertimit gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

1 (nje) inxhinier hidroteknik- Kerkohet inxhinieri hidroteknik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit punime te cilat jane te percaktuara ne preventivin fillestar e perkatesisht ne sesionin : *punime per bordure, kunet dhe kub.*

- - 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf- Kerkohet inxhinieri topograf pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi.

2.3.6- Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- **1 (një)** punonjes të pajisur me çertifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi I kuq ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **1 (një)** punonjes të pajisur me çertifikatë “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për 1 (nje) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjesi të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punesuar minimalisht 5 (pese) drejtues të makinerive të renda Manovrator dhe 7 (shtate) shofere, për të cilet duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme deshmi e aftësisë profesionale perkatese lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesen e shoqërisë minimumi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet

teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik për kryerjen e punimeve të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome/ deshmi profesionale përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (nje) gjeodet/ topograf
- 1 (nje) punonjes teknik ndertimi
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) betonues
- 2 (dy) hekurkthyes

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve të specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkëpunim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Punëtorët e specializuar (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtores) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë punëtores të specializuar sipas pikës 6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat dhe licensat si me poshte:

ISO 9001:2015 (Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

ISO 14001:2015 (Sistemet e Menaxhimit Mjedisor) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 45001-2018 (Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO sipas zërave dhe natyrës së të punimeve që do të marre përsiper të realizojë sipas marreveshjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur License per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve jo te rrezikshme qe kane ndikim ne mjedis, kodi III.2.B, te leshuara nga Qendra Kombetare e licensimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe prapjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*.

2.3.11 Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e teknike që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8) konkretisht:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Eskavator me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
	<i>Eskavator me zinxhire</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 18 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
3	<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës 10-18 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
4	<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës 5 - 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Kamioncine deri në 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
6	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Rrul 4-9 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
8	<i>Rrul 10-15 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
9	<i>Rrul mbi 15 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
10	<i>Fadrome me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Buldozer</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Autobitumatrice</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
16	<i>Autopompe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
17	<i>Betoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
18	<i>Vibrator thellesie</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
19	<i>Minieskavator</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Minifadrome</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
21	<i>Kamion me vinc</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

22	<i>Deflektometer per matjen e ngjeshjes se shtresave te rruges</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
23	<i>Fabrike betoni</i>	<i>Ne pronesi/me qera ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
24	<i>Fabrike prodhimi tubosh betoni</i>	<i>Ne pronesi/me qera ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
25	<i>Fabrike asfalti(jo me larg se 40Km)</i>	<i>Ne pronesi/me qera ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
26	<i>Nyje inerte</i>	<i>Ne pronesi/me qera ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>

a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet -dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:-leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë për transport mallrash brenda vendit.

b)Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:a) kontrata perkatese noteriale e qerave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:-leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë për transport mallrash brenda vendit.

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet gertifikatë për transport mallrash të rrezikshme leshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerave, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është leshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-se duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

1) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

3. Analizat e cmimeve për çdo ze të preventivit mosparaqitja e tyre përben shkak për skualifikim.

4. Çdo ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori. Në rast BO grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratorëve perkates.

Grafiku i punimeve në përputhje me zerat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik".

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në keto rregulla", si dhe percaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Në çdo rast, përpara **publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me originalin...", sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjesve dhe i mjeteve/pajisjeve te kerkuara do te deshmohet nëpermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit gjate fazes se ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara fazes se nenshkrimt te kontrates do t'i kerkoje ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit te Prokurimit Elektronik qe te dorëzoje dokumentet provuese per vetedeklarimet e bera ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, si dhe dokumentet e tjera te kerkuara sipas Shtojces 8 te DST. Mosparaqitja e dokumentacionit per disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do te jete kusht s' kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër eshte kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve eshte percaktuar ne varesi te volumeve te punimeve percakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshem te vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike jane hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do te bashkengjiten dokumentave te tenderit ne SPE.

NJESIA E PROKURIMIT
